

# KPK shkarkon nga detyra prokurorin e Tiranës, Alket Mersini

Gjatë seancës dëgjimore, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit evidentoi mungesë burimesh financiare për krijimin e pasurive.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Prokurori Alket Mersini, pas vendimit të KPK për shkarkim. Foto:Edmond Hoxha/BIRN

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, KPK vendosi të mërkurën shkarkimin nga detyra të prokurorit të Prokurorisë së Tiranës, Alket Mersini. Trupi gjyqësor i KPK i përbërë nga Etleda Çiftja kryesuese, Pamela Qirko raportuese dhe Xhensila Pine anëtare e përfunduan procesin e rivlerësimit për prokurorin Mersini në të tri kriteret.

Gjatë seancës dëgjimore të hënën më 14 shtator, Komisioni identifikoi pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe pasaktësi në deklarime.

Komisioni konstaton se Mersini nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat në vlerën 8.5 milionë lekë të përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan dhe për pasojë kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare për blerjen e banesës në Tiranë.

Mersini tha se diferenca e përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan nuk ishte 8.5 milionë lekë sa konstaton KPK, duke argumentuar se kishte kryer edhe shpenzime të tjera për këtë pasuri. Ai shpjegoi se nuk e zotëronte si pronë në vitin 2011 apartamentin në Elbasan dhe se në këtë periudhë nuk parashikohej në ligj që

të paguhej tatim për të ardhurat e përfituara nga shitja e një të drejte reale, por vetëm për të ardhurat e shitjes së një prone.

KPK konstaton se prokurori Mersini nuk kishte patur mundësi financiare për blerjen e dy apartamenteve. Në seancën dëgjimore ai u pyet edhe lidhur me transferimin e një vlere 40 mijë euro nga shoqëria ndërtuese ku kanë blerë apartamentin në Tiranë, në llogarinë e bashkëshortes. Mersini tha se sapo e kishte mësuar këtë gjë i kishte thënë bashkëshortes që t'ia kthente shoqërisë dhe se kështu kishte ndodhur.

Prokurori Mersini u vlerësua pozitivisht për pastërtinë e figurës dhe nuk u identifikuan probleme për profesionalizmin.



**RRETH AUTORIT**

### **Edmond Hoxhaj**

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.